



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL III/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (tretë) për vitin 2026 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 18.03.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

z. Flamur Bytyçi

z. Enver Shabani

znj. Mimoza Bajraktari

znj. Sanie Kuçi Rexhepaj

znj. Laureta Tafaj

z. Dardan Berisha

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Eko-Theranda”;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e plani vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**

Kryesuesi-përshendet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe për një pikë shtesë e cila ka ardhë nga Kryetari duke u bazuar në kërkesën e Shoqatës Zona e Pashtrikut e cila kërkon nga Kryetari ti jepet pëlqimi për ndarjen e mjeteve financiare në rregullimin e shtatorës të heroit të kombit Tahir Sinani.

Kryetari-ne e kemi një marrëveshje Komunitet e Regjionit të Prizrenit,Tahir Sinani ka qenë Komandant i Zonës së Pashtrikut,ju e dini që Pashtriku kan bë pjesë të gjitha brigadat e Komunitet Suhareka,Prizreni,Rahoveci,vitin e kalum janë dakordu për me ngritë Shtatoren në Prizren por përshkak të problemeve financiare që kemi pas,unë e kam pas për obligim me pru dhe këto mjete do të paguhen nga Drejtoria e Kulturës,Shtatorja është për uru me 28 Nëntor të vitit kalum,dhe unë e kam pas për obligim me shti në rend të ditës.

Flamur Bytyçi-A është përfundu Shtatorja dhe pse ne kemi mbetë kaq vonë me pages?

Kryetari-po është përfundu,por nuk kemi pas mjete financiare përshkak të përmbaruesve,këto paguhen vetëm prej subvencioneve mallrav shërbimeve.

Kryesuesi-e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuqi Rexhepaj-Përshendetje për të gjithë,në procesverbal ka gabime drejtëshkrimore dhe nganjëherë po i hup sensi fjalëve,njëri nga rastet ku un e kam pasë fjalën një fjali që është e shënime nuk ka as kuptim “po lidhna pak me qështjen që e tha Laureta arsyen pse nuk kam me votu” unë nuk kam thënë që ska me u votu sepse në fund shihet që unanimisht votohet dhe kisha pas si lloj kërkese pak më me vëmendje me i ndëgju fjalët.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 1 me vërejtje

Miratohet me vërejtje

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin për pikën e dytë

Avni Bytyçi-përshendetje për të gjithë,realisht kjo rregullore ka fillu me iniciativën e Njësisë së Eko-Regjionit në Suharekë përshkak të vështirësive financiare që ju kan paraqit kohëve të fundit,për arsye se e vetëmja Komuna jonë në nivel Regjional tarifa apo taksa për çështjene pagesave së mbeturinave është minimal në nivel regjional,pas shqyrtimit të kërkesës së Njësisë së Eko-Regjionit Kryetari i Komunës ka formu grupin punues të cilin grup e kam udhëhequr unë dhe kam qenë Kryesues i grupit punues dhe kemi ardhë në përfundim dhe kemi miratu kët projekt-rregullore duke u bazu që ka kompetenc dhe autoritet Komuna dhe Kuvendi edhe autoritet Komuna dhe Kuvendi që ta miraton,konkretisht te kompetencat vetanake të Komunës që e obligon Komunën të merret me qështjen e menaxhimit mbeturinave tani vjn në shprehje ligji për financat e pushteti lokal icili i jep kompetencë dhe autoritet Komunës nga shërbimet që u ofrohen qytetarëve të krijon të hyra vetanake dhe ligji specifik që e obligon Komunën që ta rregullon këtë qështje është ligji për mbeturinat i cili i jep kompetenc dhe autoritet dhe obligon Komunën që të nxjerrë një rregullore të përcakton procedurat e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave si dhe të përcakton tarifën për shërbimet që ofrohen nga Komuna apo nga kontraktuesi.Po mendojë që këtë rregullore e kemi bënë duke i ndjekur të gjitha procedurat ligjore ashtu siq kërkohen duke mbajtur konsultime publike mirpo në pika të shkurta do ta elaboroj.

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë qështjen e menaxhimit të mbeturinave Komunale dhe mbeturinat nga afektet tjera,të natyrës së ngjajshme me ato të amvisërisë,të përcakton lartësin. E taksave të menaxhimit të mbeturinave të amvisërisë,mbeturinave komerciale,institucionale me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm për administrimin financiar,ruajtes së natyrës,dhe interesat tjera të përgjithshme.Në kuadër të kësaj projekt-rregullore i kemi parapa edhe mbeturinat të cilat i përjashton ligji për mbeturina që ti trajtojë Komuna si dhe i kemi parapa përgjegjësit e Komunës për menaxhimin e mbeturinave,po ashtu e kemi parapa edhe sistemin e menaxhimit të mbeturinave i cili sistem ka për qëllim të bëhet trajtimi dhe menaxhimi i mbeturinave nga kontraktuesi përmes sistemit derë më derë dhe përmes sistemit të kontinjerëve të vendosur nëpër hapësira publike.Kemi bërë kategorizimin e gjenerueseve të mbeturinave që konsiderohemi që jan konsumatorë të amvisërisë,konsumatorët industrial,dhe institucional,për herë të parë ne si grup punues kemi ardhë në përfundim që te kategoria e konsumatorëve të amvisërisë ti ndajmë në dy grupe konsumatorët e amvisërisë dhe konsumatorët individual tash të gjithë jemi të vetëdijshëm që në Komunën tonë dhe në gjithë Kosovën ka familje që jetojnë nga një anëtarë i familjës dhe kemi marrë parasysh që ti ndajmë këto kategori dhe ti lehtësojm sa i përket pagesës për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.Mënyra e pagesës e kemi parapa që mund të bëhet edhe me

këste. Tarifat paaguhën për qdo muaj po ashtu është një risi të qështja e mërgimtarëve apo diasporës në këtë projekt-rregullore kemi para pa të paguajnë 3\$ në muaj sikurse qdo gjenerues i mbeturinave që jetonë në Kosovë mirpo dallimi në mes qmimeve dallon.

Qështjen e mbikëqyrjes së kësaj projekt-rregullore do ta bëjë inspektorsati i Kounës së Suharekës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, dhe përfund e keni tabelën A që i përcakton të gjitha tarifatat, si grup punues në i kemi propozu këto tarifa ndërsa autoriteti që vendosë dhe miraton këto tarifa është Kuvendi i Komunës. Ky ishte prezantimi në pika të shkurta ndërsa për qështjet konkrete dhe pytjet specifike jemi të gatshëm të ju përgjigjem.

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë, ju e quajtet si fatkeqësi që nuk ka kalu në mandatin e kalum unë po e quaj fatmirësi për qytetarët se në këtë kohë kriza që jemi, nuk po e shohë ndonjë ndryshim nga hera e kalume dhe nuk po e shoh diqka madhorë që ne me votu kësaj here, atëherë keni ardhë me idenë se keni me i rritë pagat e puntorëve në Eko-Regjion kemi kërku vendim për atë rritje dhe nuk e keni pru asnjëherë kemi qenë të gatshëm me votu, kësaj here na jepni një arsye të madhe pse ne me votu dhe unë me i bindë edhe kolegët e mi në asamble që na me votu.

Kryetari-ne jemi duke u bërë gati me krijimin e Eko-Therandës në momentin që objekti përfundon në Shirokë, komplet hapësira ka me shku, na kem me u kan kompania komunale e jona kompletë kompetencat nga Prizreni kan me kalu, ju e dini që ne jemi aksionarë 13% për fatë të mirë të gjithat donacionët që 7 vite që i kemi marrë janë 8 kamionë nuk i kemi regjistru në emër të kompanisë por janë në emër të Komunës ata kamiona kalojnë kompletë në kompetencë të Eko-Therandës. Përshtkak që sotë shpenzimët janë rritë kërkojmë nga ju mirëkuptim për të rritur tarifën për të pasur një qytet të pastër. Prej se ka fillu në Komunën tonë nuk është bërë asnjë rritje.

Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë, për mu si rregullore në parim duket në rregull mirëpo ka shumë ? mbrenda psh njëra ndër arsyet është ju e keni cekë sektorin e menaxhimit të mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Emergjencës A ka sektor momentalishtë Komuna jonë për menaxhimin e mbeturinave ? Pyetja e dytë e keni bërë m ekriju një sistem për regjistrimin e. Përsonave, objekteve ,a. e keni bërë një përlllogaritje sa është kosto me ndërteu një sistem? kush ka me mbikëqyrë, qysh keni mi regjistru qytetarët a e keni menu këtë aspekt, tjetra qka unë nuk pajtohem me këtë përfunim. Ju që e keni bërë psh te kategorizimi i bizneseve psh i njejt biznes si në Suharekë si në Budakovë pagun njejtë që për mua nuk është në rregull. Një kamionë me marrë mbeturina në Suharekë dhe me shku në Budakovë a nuk e keni parapa shpenzimet e naftës amortizimit. Ky kategorizim është keq psh avokatura nuk mundet me gjeneru mbeturina qysh e keni kategorizu ju, unë mendojë që këto rregullore duhet me u kthi mbrapa dhe dëgjimin publik që e keni bërë qytetarët nuk jn të informuar, as bizneset nuk i keni ftu as me përfaqësuesit e zonës industriale shoqatës së biznesev nuk e keni diskutu.

Avni Bytyçi-Siq e përmendi edhe Kryetari kemi plan me fillu procedurën përmes komisionit të aksionarëve që është themelur në Kuvend dhe ai është organ kompetent dhe ka autoritet që të fillojë procedurën e ndarjes së Kompanies nga Kompania regjinale Eko-Regjioni dhe ta fuqizojmë kompanin tonë Eko-Therandën që është 100% Komuna aksionare, por parapsakisht ne jemi tu u mundu që të kompletojmë infrastrukturën ligjore dhe ti hpim rrugën asaj ndërmarrije publike . Është e vertetë që sektori për menaxhimin e mbeturinave për momentin nuk është i themeluar në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë mirpo në momentin që ne i kryejmë të gjitha procedurat ligjore që na takojnë në Eko-Therandë atëherë Kryetari Komunës do ta ketë në konsideratë që ta themelojë sektorin e Emergjencave në Drejtorinë e shërbimeve publike.

Flamur Bytyçi-ju po e përmendeni shpeshë për aksionët 13% dhe dojmë me kthi vetë me menaxhu vetë a i keni bo shkresë Ministrisë që me i falë, a ka borxhe EKO-Regjioni qysh keni me i nda, unë logjikën e. Ndarjes nuk po. E kuptojë

Kryetari-Në moment që fuqizohet Komuna jonë në vazhdojmë me zbatu ligjin dhe e marrim në kompetencë.

Laureta Tafaj-a mundem me i marrë këto kompetenca pa e bo rritjen e çmimit,se qka nëse ne e rrisim çmimin dhe Ministria na kthen?

Kryetari-jo nuk mundemi.

Flamur Bytyçi-unë po du me e ditë çfarë analize financiare keni ba për me e rritë këtë tarifë?

Kryetari-në bazë të analizës së kompanisë,sa mblidhen taksa,sa shpenzime krijohen,sa shkojnë për paga,sa shkojnë për amortizimin e kamionëve,në bazë të këtyre shpenzimeve që i ka kompania me tarifën që është tash nuk mundet me funksionu.

Avni Bytyçi-nëse i referoheni nenit 11 është shumë e kjartë dhe i përcakton analizën të cilën e kemi bë dhe për çfar arsye kemi fillu procedurat për rritjen e kësaj tarife.Ne kemi pas takime të vazhdueshëm me Njësien punuese dhe me Kryetarin e Komunës për me arritë këtë rregullore dhe për me fillu procedurat për miratimin dhe hartimin e kësaj rregullore,në bazë të informacionëve që i kemi nga z.Avdyli kompania është gati në kolaps si pasojë e tarifës ë ultë që e ka Komuna jonë.Është e vertetë që këta janë në aksione edhe me Komunën e Prizrenit,Dragashit,Rahovecit mirpo për aq sa kan pagesa aq ju kthehen edhe të hyrat.Këtu shihet e kjartë se për çfar arsye kemi kërku me e rritë ju po e shihni krejt enormën që jan bë të gjitha shpenzimet në jetën e përditshme,e vetmja tarifë që nga 2020 që nuk është ndryshu.Tek çështja e ndarjës Flamur ne e kemi komisionin,ne kemi me fillu procedurën,të gjitha obligimet të drejtat që na takojnë në kuadër të 13% që jemi aksionarë në ndërmarrjen e Eko-Regjionit,Komuna e suharekës ka me i marrë për obligim kështu e trajton ligji mbi mardhënien e detyrimeve tek çështja e kontratimeve.

Enver Shabani-këtu nuk kisha pranë,sepse ne kemi bë marrëveshje pa shkrim kur vjen puna me u nda,na për këtë arsye e kemi themelu Eko-Therandën për mos me i bartë obligimet që i ka Eko-Regjioni,në heshtje ka me u nda,6 kamionët që janë donacion janë të regjistruar në emër të Komunës tonë dhe me automatizëm i kalojnë Eko-Therandës dhe unë nuk e besojë që kemi me marrë obligime.Do analiza i kemi bë edhe me Jica Japoneze që kemi punu vite me rradhë,ata kan bë analiza edhe për shpenzimet,edhe për numër të banorëve,edhe për hoteleri,amvisëri,ndërtimtari të gjitha këto i ka bër Jica japoneze dhe ja vlenë me u rritë pak çmimi i shërbimeve sepse jan në situatë të keqe kompania.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,sa i përket rregullorës unë mendojë se elaborimin e bëri zyrtari ligjorë përveq ksaj nëse dalim në teren e shohim gjendjen aktuale si është në teren nuk ma merrë mendja që gjendja aktuale e kompanisë dhe e puntorëve që përballen me këto problematika është e njejtë me vitin e kalum apo para dy viteve dmth gjendja po ndryshon qdo ditë,ne duhet me pas parasysh që tarifat regjionale në krejtë regjionin e Prizrenit jan të rritëne vetëm Komuna e Suharekës është me tarifat më të lira.Themelimi i krijimit të Ndërmarrjes Eko-Theranda realisht e ka kriju një far ndarje sepse ka që shumica e punëtorëve që kan mbetë aty sidomos punëtorët administrativ kan kalu tek ndërmarrja tjetër,ajo qka po më intereson mu e kam lexu projekt-rregullore përveq menaxhimit të mbeturinave territorit të Komunës së Suharekës a duhet ti shtohet dhe ndryshimi i tarifës sepse kjo krijon masandej hezitim apo kalon si rregullore apo edhe rritja e tarifave.

Avni Bytyçi-nëse e ke lexu me vëmendje rregullore pjesë përbërese e kësaj rregullore është shtojca numër A e cila përcakton tarifat.Nëse i referohemi nenit 1 qëllimi i kësaj rregullore është çështja e menaxhimit të mbeturinave dhe përcaktimi i tarifës.

Mimoza Bajraktari-përshendetje për të gjithë,kam qenë edhe mandatin e kalum dhe është diskutu vazhdimisht kjo rritja e çmimit,duke marrë parasysh se në të vertetë krejtë çmimet janë rritë pse pikërishtë kësaj kompanie të menaxhimit të mbeturinave nuk duhet me ju rritë,duke e ditë që edhe

ata duhet me pasë të ardhura,duhet me jetu,ne gjithë herë jemi lidhë prej asaj se a keni me i rritë pagat,po patjetër kan me ja rritë pagat përderisa janë rritë krejtë çmimet,me ato qka po thuhet këtu në bazë të personave që e menaxhojnë ata nuk kan ngritje të pagave dhe tjetra është që ne nuk kemi me pasë as punëtorë sepse ska me pas paga,4.50€ me ti marrë të gjitha mbeturinat te shpia dhe ne e diskutojmë për 6€ në fundë të muajit këtë rast 1.50€ më shumë,të gjitha shpenzimet tjera janë rritë tu nisë nga energjia elektrike etj kemi ardhë vetëm te kompania e mirëmbajtjes vetëm ne si Suharekë po i ruajmë qytetarët,në këtë rast Flamuri e tha që kemi pasë takime me qytetarët dhe kemi diskutu secili prej nesh dhe unë as një qytetarë skam pas rast deri tash me taku dhe me më thanë pse u rrit kjo dhe secili ka me thën që e para është me u rritë çështja e mbeturinave tu e marrë parasysh siq kemi jetu më herët secili qytetarë mbeturinat në oborrë ose kur vije fundi muaji të gjitha mbeturinat në lum apo rreth përrojave dhe sot në asnjë vend nuk ki mbeturinave,dhe mua po më habit fakti që qdo herë e kemi diskutu për 1.50€ dhe tjetra po e shohë që po i drejtohëm Kryesuesit apo ekzekutivit krejtë me një gjuhë të ashpër pse sikurse kta me qenë gjithmonë kundër qytetarëve pavarësishtë që ne jemi asambleista dhe kemi të drejtë për me kritiku por jo në mënyrën që qdo herë të shohim zi.Mua më së shumti po më vret gjuha që jemi duke e përdorë,dhe ne si këshilltar asnjëherë nuk ulemi me diskutu me ekzekutiv dhe qka mundemi me ndryshu.

Laureta Tafaj-ne nuk jemi duke përdor gjuhe të ashpër dhe as nuk jemi duke e fy askënd,vetëm kemi kërku një vendim që është thën për rritjen e pagave.

Dardan Berisha-kërkun këtu nuk shkruan Mimosë për rritjen e pagave për punëtorë ne e dijmë gjendjen aktuale në teren gjithqka që ne e votojmë këtu në KPF ne e votojmë qka na sillet këtu.Unë mendojë që këtë rregullore ne duhet me përkrah për hirë të punëtorëve të cilët përballen me probleme të shumëta qdo ditë.Ne votojmë veq qka na del përpara në këtë rast kjo rregullore. e bën ndryshmin e tarifave,kush është me ndryshu e voton kush nuk është nuk e voton dhe ne nuk jemi duke përdorur kurrëfar gjuhe.

Armend Krasniqi-kam një pyetje për z.Avdyl, a keni ndonjë statistik apo ndonjë anketë që keni bërë pyetje te qytetarët që a ndikon rritja e çmimit te ju?

Avdyl Kabashi-po kemi anketa 200 që jan për me rritë qytetarët sepse janë të kënaqur me shërbimin.

Flamur Bytyçi-Sa është obligimi që ju kanë qytetarët juve dhe bizneset,sa është vlere totale e borxhit?

Avdyl Kabashi-ne Suhareka nuk i kemi dokumentat sepse i ka Prizreni financat dhe nuk kam marrë informata por mundem në seancë me ja u sjellë.Mirpo po ju tregojë rreth shpenzimeve 250.000€ mbeturina dhe naftë,mbi 300.000€ paga,200.000€ mirëmbajtja e kamionave,me faturim jemi minus dhe kemi mbledhë borxhet e mëhershme dhe anëtarët e bordit kan dashtë me bë secila Komuna me i pagu vetë punëtorët qysh kanë të ardhura,mirpo nuk kan leju.

Flamur Bytyçi-për deri sa Komuna jonë është aksionarë 13% ne duhet me ditë sa kemi obligime.Dhe cila është ajo siguria që nëse ne e rrisim tarifën juve ju rritën pagat.

Avdyl Kabashi-siguria për me u na rritë pagat neve për 100 euro duhet me e rritë tarifën si Komunat tjera nga 8 euro.

Laureta Tafaj-a është 8 euro na e sjellë vendimin që ka me ju u rritë pagat juve punëtorëve ne kemi me votu me 8 euro.

Avdyl Kabashi-atë e vendosë bordi i kompanisë.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,përshtet tek kjo rregullore çështjen e tarifave nuk po e shohë shumë problematike por me Flamurin pajtona tek pjesa e mungesës së analizave të juaja që patet me pasqyru në mënyrën se qysh i keni përcaktu rritjen e tarifave por që po rriten tarifat për mu nuk është najfar shqetësimi i madhë më shumë po më shqetëson forma e pozicionimit

ose e zbatimit të rregullorës, nëse kjo rregullore hyn në fuqi Komuna me thën e paaftë pak keq por me duket me staf të mangët për me zbatu rregulloren qysh është parapa në bazë të këtyre neneve që na keni dhën. Thotë që Komuna është përgjegjëse për vjeljen e pagesave në anën tjetër thoni që ka me u bë sektori për menaxhimin e mbeturinave ,qysh keni menu me funksionu kjo pjesë, a ka me u kriju sektori për menaxhimin e mbeturinave, stafi dhe ne e kemi problematikën e rritjes së numrit të zyrtarëve në Komunë, herë po përmendet Eko-Regjioni herë Eko-Theranda mirpo në rregullore nuk po përmendet asnjëra edhe po thuhet që grumbulluesi i mbeturinave përcaktohet përmes një leje mjedisore komunale qysh ka me funksionu kjo formë me na sqaru më shumë përshkak se në krijimin e legjislacionëve apo rregulloreve, ligjeve si Shtet jemi të parët mirpo në zbatim po qalojmë shumë, kështu që si rregullore është në rregull vetëm që qysh zbatimi ajo po më duket që Komuna ka me qalu në këtë proces, jam steptike në zbatim. Njëra ndër arsyet në mandatin e kalum një rregullore e tij nuk është miratu është edhe mungesa e debatit publik, rregullorja ka dal në shqyrtim publik por asnjëherë Komuna nuk ka organizu debat publik me qytetarët, mirpo edhe tash debati publik i 6 Marsit që është mbajtë ka qenë vetëm me zyrtarë përshkak se më duket po qaloni tek pjesa e informimit, as asambleistëve nuk po jeni në gjendje një ftesë me ja drgu për me qenë pjesë e debatit është shumë e vertetë që obligimi ligjor është me shpall vetëm në web faqe të Komunës dhe tek dera e Komunës mirpo sa janë qytetarët që e shfletojnë webfaqen e Komunës ,të paktën në radio me qitë edhe ajo është mundësi dhe ata që jan duke e ndëgju munden me ndëgju që është një debat të paktën ndëgjojnë që është tu punu diqka rreth mbeturinave.

Avni Bytyçi-në projekt-rregullore para se me ardhë këtu kemi ardhë me një ndryshim shumë të vogël përmbajtësor, tek çështja e menaxhimit, faturimit, inkasimit për mes kësaj rregullore ka mi kalu Eko-Regjionit deri sa Komuna ta merrë në menaxhim komplet çështjen e mbeturinave, dhe në Asamble rregullorja ka me ardhë me ndryshime që faturimin, inkasimin, ka me bë Kompania Eko-Regjionit deri sa Komuna ka kontratë.

Sanie Kuqi Rexhepaj-deshta me u ndërlihd është që njëri nga nenet po thuhet që qekjo leja mjedisore komunale jepet sipas legjislacionit në fuqi unë nuk është që e kam lexu atë ligj të menaxhimit të mbeturinave ndoshta edhe ish Drejtori Enveri ka informacion qysh përcaktohet ajo dhe kujt i jepet ,kush mundet me apliku për atë leje mjedisore? Sepse këtu po lihet pak si e hapur, knej po flasim për Eko-Therandën në takime mirpo brenda për brenda rregullores nuk po përmendet që Komuna e ka një ndërmarrje publike pse nuk është mirë me përcaktu që Komuna e ka një ndërmarrje dhe ju po e leni pak të msheftë.

Avni Bytyçi-Jo nuk jemi te lën absolutë të fshehtë dhe po besojë që ti kto sene je ka i kupton me vetë faktin që ti po i bën pyetjet specifike dhe konkrete je ka e kupton, leje mjedisore jan dy njëren e lëshon Komuna tjetren e lëshon Qeveria e Republikës së Kosovës, çështja e menaxhimit të mbeturinave mundet me apliku vetëm kompanitë që janë të licencuara për trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe në momentin ne kur fillojmë procedurat për ndarjen e kësaj kompanie ne kemi me fillu procedurat nga Eko-Theranda për me marrë licencë dhe ka me u pajisë me të gjitha lejet mjedisore dhe të gjitha dokumentet tjera që i takojnë sipas ligjit për ndërmarrje publike, ligjit për mbeturinat.

Sanie Kuqi Rexhepaj-deshta me u ndërlihdë pak me Mimosën, përshkak se unë mendojë ne si Komunë jemi shembull në formën e mënyrës së komunikimit dhe e dyta ne jemi të thirrur me dhën mundin apo dijen tonë që e kemi për me inpërfeksionu qdo pikë, qdo vendim apo qdo rregullore qka është qajo është qëllimi jonë.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 2 me 2 ndryshime të vogla.

4 për, 1 kundër 2 abstenime miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Eko-Theranda”;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-pyetja ime është tek çështja e anëtarëve të komisionit a është ka respektohet që dmth përfaqësimi i anëtarëve të komisionit me kan i partive të ndryshme psh një me qenë i koalicionit qeverisës një me qenë opozita.

Kryesuesi-ne këtu jemi subjekte të ndame edhe pse jemi në koalicion.Ligji e parashehë 3 anëtarë në komision.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 3

Unanimisht miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-nuk e di pse po më duket që e kemi diskutu për këtë lokal faktikisht në mandatin e kalum që i ka skadu kontrata,kur na e ka sjellë Armendi si Drejtorë një listë të nënshkrume u kan që i ka skadu apo ka qenë në pragë nuk jam shumë e sigurtë sidoqoftë e kemi diskutu si lokal,normalishtë është shumë në rregullë që me inicë ,kërkesën e vonesës është arsyetu përshkak të zgjedhjeve të vitit kalum,një pyetje e kam sa e dijmë në kur lokalet jepen në shfrytëzim duhet me qenë të liruara a është e njejta edhe për afatshkurtë apo edhe për afatgjatë,dhe për krejt këtë kohë që nuk ka pas kontratë a ka pagu diqka apo nuk ka pagu ?

Mensur Selimaj-përshendetje për të gjithë,duke marrë paarasysht që i ka skadu kontrata në një periudhë zgjedhore,biznesi në fjalë ka qenë pagues i rregulltë i qerasë,e kam njoftu që i ka skadu kontrata dhe e kam njoftu që ka me shku në Asamble,dhe në moment që e merrë pëlqimin në KPF për me shku në Asamble ja dërgojë njoftimin e rradhës për me liru lokalin dhe për me fillu me procedurat.

Sanie Kuçi Rexhepaj-në këtë rastë me liru lokalin me i hekë kompletë ato dhe me siguru një hapësirë tjetër por kjo bëhet në momentin që veq skadon kontrata e jo në momentin kur vjenë në KPF për diskutim dhe për atë pyta a ka kry pagesa,dhe po e di që ka qenë e rregullt po e di që edhe Komuna ka bashkëpunim me Edorin,për aqë koh sa kam qenë Drejtoreshë kan qenë krejtë në rregull për qdo shërbim që na kan ofru si Librari por veq çështjen si procedurë jemi duke e diskutu.

Avni Bytyçi-faktë është ajo që e the ti se ligji e thotë në momentin që inicohet procedura për dhënjen në shfrytëzim pa marrëpaarasysht a është afatgjatë apo afatshkurtë duhet të jetë prona e lirë dhe të jetë e regjistruar në regjistrin e kadastërit,ky lokal është i regjistruar në regjistrin e kadastërit ne kemi bisedu me Drejtorin,ështënëpagues i rregullt i qersë,nuk e di kur i skadon kontrata pamvarsisht kur i skadon kontrata ligji mbi mardhënien e detyrimeve dikun nga dispozita e nenit 500 e thotë nëse dikush e shfrytëzon një send dhe asnjëra palë nuk e njofton për shkëputjen e kontratës konsiderohet që kontrata është e vazhdueshëme heshturazi deri sa të njoftohet nga organi kompetent.Në momentin që ky vendim e merrë miratimin nga Kuvendi Drejtori e ka për obligim

që ta obligon ta lirojë lokalit dhe në lokal kanë të drejtë të konkurojnë të gjithë qytetarët pa dallim dhe kanë trajtim të barabartë secili ai që konkuron në ankand publik.

Flamur Bytyçi-unë këtu e kam listën e borxheve dhe kisha dashtë me qenë Drejtoresha e Financave këtu me qenë se e ka ba kërkesën Drejtori dhe këtu në këtë listë zyrtarë po figuron 2203 euro qeky borxhë për cilën periudhë është?

Mensur Selimaj-mundet me qenë borxh i vjetër mirpo borxhin e ri sipas zyrës së financave borxhë të ri nuk ka.

Avni Bytyçi-falja e borxheve është bë vetëm për çështje të aktivitetit të biznesit,çështja e qerasë nuk ka kompetencë ta fal sepse ai lokal është marrë me konkurim,tek çështja e borxhit unë nuk po e di asë Drejtori nuk po edin mirpo megjithatë me atë çështje të borxhit diskualifikohet komisioni ka për obligim as me leju me konkuru pa i fshijë obligimet që i ka.

Kryesuesi – e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin për pikën e pestë

Sanie Kuçi Rexhepaj-vendimi paraprak që e miratum dhe ai ke shumë i qartë në referimin e lokalit,dmth ke me numër të lokalit me adresë të rrugës,në këtë rastë ne që kemi qenë në mandatin e kalum mundemi me shlefu materialin e më hershëm mirpo këta që janë të këtij mandati dhe ai komision që formohet mirë është me pasë parasysh mbrenda për mbrenda vendimit për cilat banesa jemi tu e pas fjalën përshkak se po referohët vetëm numri i vendimit që është kanë atëherë por që nuk po specifikohet cilat banesa janë dhe ne duhet me marrë me shfletu atë vendimin për me kqyrë cilat banesa janë,kërkesa jemë në këtë rastë është me u specifiku për cilat banesa jemi tu fol.

Avni Bytyçi-në vitin 2024 është marrë vendimi paraprak të zhvillohet procedurat e konkurimit të hapur për dhënjen në shfrytëzim të 4 banesave të Komunës në qendër të qytetit,përshsk se kimisioni e ka neglizhu punën pak dhe nuk ka shku taman qysh kërkohet dhe me përfundu për kundër që e ka hap konkurimin e hapur kan konkuru njerëz të interesuar komisioni ka bër hapjen e ofertsve,vlerësimin e ofertave dhe Presidentja i ka shpallë zgjedhjet dhe në momentin që Presidentja i shpallë zgjedhjet ligji për dhënjen në shfrytëzim të pronës thotë që pezullohen të gjitha aktivitetet për dhënjen në shfrytëzim dhe komisioni e ka pezullu punën.Formohet komisioni dhe vazhdohet puna aty ku e ka lanë komisioni paraprak ti kryejn procedurat siq e kerkon ligji dhe rregullorja dhe ti rekomandojë Kuvendit për miratim dhe Kuvendi është autoriteti që e miraton.Në vendimin paraprak asnjëherë në komisione nuk ka qenë e specifikume cili është por ka qenë vetëm numri i vendimit paraprak dhe data ,dhe po ju zotohem që për Asamble ka me ja u dërgu vendimin paraprak edhe për banesa edhe për lokale.

Sanie Kuçi Rexhepaj-brenda për brenda këtij vendimi që ne jemi duke e votu me qenë të specifikume për cilat banesa dhe lokale po bëhet fjalë dhe jemi tu marrë vendim.

Te pjesa që e spjegove qysh kanë rrjedhë procedurat e komisionit të kalum the që komisioni e ka bë shpalljen,vlerësimin pyetja ime është a ka mbetë te vlerësimi apo e kan bë edhe rekomandimin?

Avni Bytyçi-e ka përfunduar vlerësimin e ka bërë njoftimin e ka bërë shpalljen publike mirpo nuk e ka bërë raportin për Asamble për shkak të shpalljes së zgjedhjeve dhe janë dy procedurat e para me formë komisionin e dyta me kthim në pikën 0.

Armend Krasniqi-përshendetje për të gjithë,pajtohem me mendimet që e kanë lyp me ditë ku është lokacioni për para se me ardhë në Drejtorë nuk kanë ditë ku gjindet një banesë e Komunës sepse nuk ka pasë asnjë regjistër kadastral me numër ku është një banesë,në marrjen e. Detyrës si Drejtorë kam marrë iniciativën që ta bëjë regjistrimin e të gjithave pronave komunale dhe kemi vendosë për 4 banesat të cilat është ky vendim kemi dalë në teren kemi konstatu se po banojnë njerëzit që 20 vite dhe nuk kanë pagu asgjë kemi marrë vendim me i heq prej banesave dhe e kemi inicuar procedurën për me i dhënë në shfrytëzim.

Laureta Tafaj-një pyetje për Drejtorin kur ke ardhë a ke gjetë ndonjë regjistër të këtyre pronave?

Armend Krasniqi-jo nuk kam gjetë asnjë regjistër nuk ka ekzistuar.

Laureta Tafaj- Kryesues a e dinë që në mandatin tim të parë e kemi bërë verifikim e të gjithave pronave të Komunës në një komision dhe tregojë që nuk është shumë e rëndë për mu.

Flamur Bytyçi-qysh keni marrë vendim për me i qitë prej banesës për këta që nuk kanë pagu ,dmth ti e ke marrë vendimin për me i largu nga banesat?

Armend Krasniqi-kur e kam konstatu se prona është e Komunës dhe ata nuk kanë pagu dhe unë kam marrë vendim me i largu nga banesat.

Flamur Bytyçi-ti ke marrë vendim për me qitë dikur prej banesave që nuk ka as kulm mbi kokë dhe në anën tjetër dmth ti për Zonën Industriale për të cilën ti je kan përgjegjës nuk ke marrë vendim për me i largu bizneset prej aty.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin për pikën e gjashtë

Sanie Kuçi Rexhepaj-pyetja ime është e njëjta si tek lokali Edori me sa e ditë këto lokale nuk janë të lirume jan duke u shfrytëzu momentalishtë prej dikujt nuk e di a kanë kontratë apo nuk kanë paguajne apo jo pyetje të njëjta dhe çështja e specifikimit për me u ditë për cilat lokale jem tu fol dhe po rekomandojë me u specifiku brenda për brenda vendimit për kan jemi tu diskutu.

Armend Krasniqi-kur kam fillu inicimin e procedurave lokalet kanë qenë të liruara.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e plani vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin për pikën e shtatë

Avni Bytyçi-në bashkëpunim me Kryetaarin e kemi diskutu dhe i kemi propozu këto pika për Kuvend nëse keni ndonjë propozim është i mirësearchurë me qëllim që të ofrojmë njësiguri më të madhe për qytetarët.

Flamur Bytyçi-e kam një lutje për Drejtorat me qenë pjesë të KPF-së sespe mundemi me pasë ndonjë pyetje,e kan obligim ligjorë me marrë pjesë.

Laureta Tafaj-trajtimi i qenëve endacak qka keni bë dhe qka menoni me ba apo qka mundemi me bë krejtë bashkë?

Avni Bytyçi-ligji për trajtimin e kafshëve nuk e lejojnë me i ekzekutu e qysh po i trajtojnë ata nuk po funksionon.

Flamur Bytyçi-pyetja ime e fundit ka të bëj për shkollat dhe po besojë Kryetari apo Drejtori i Arsimit kan informatat është çështje për Gjimnazin konkretisht për profesori Astrit Sahitaj ka bë shumë akuza profesori ndaj drejtuesëve Drejtorit të Arsimit ju e keni largu nga puna ja keni hekë orët ja keni dhën orët dikujna tjetër tash cilat jan kan veprimet e juaja si Komunë e Suharekës kundrejtë profesorit nëse akuzat e tyre jan kan pa bazë sepse ai ka akuzu shumë rënd nëse ka ndodhë qajo mbrenda në shkollë është dashtë dikush me dhën përgjegjësi sotë,por edhe nëse sështë e vertetë ajo pse nuk keni inicu procedurë padi ndaj profesorit në fjalë.

Kryesuesi-profesori në fjalë e ka normën e plotë

Avni Bytyçi-për këto aktakuza që je tu fol ti është marrë komisioni dhe është marrë Prokuroria është mbyllë ai proces.

Laureta Tafaj -nëse është mbyllë kjo pikë e kam një ankesë prej qytetarëve për çmimin e autobusëve prej Semetishtit a ka të drejtë ai me bë këtë a është i vetëmi operatorë,ja u ka hekë të drejtën e biletave mujore dhe ankesat jan shumë të mëdha.

Kryesuesi-nuk ka ndonjë organ që e rregullon këtë çështje,mirpo është në ndërgjegjen e tyre.

Avni Bytyçi-çmimi në tregë për të gjitha shërbimet është i lirë.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare;

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 8

Unanimisht miratohet

Takimi Përfundoi

12:05